



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.119/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Gillogjani anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje, dega në Besianë paraqitur kundër Koalicionit LDK-AKR, për shkak të vendosjes së posterave në shtylla elektrike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me 08.06.2017, mori këtë:

## V E N D I M

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, dega në Besianë

## A r s y e t i m

Me datën 06.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje me të cilën pretendon se me datën 06.06.2017 ka vërejtur se në rrugën “Zahir Pajaziti” në Besianë nëpër shtylla elektrike janë vendosur flamuj të subjektit politik LDK-AKR. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se koalicioni LDK-AKR me vendosjen e flamujve të subjektit politik LDK-AKR në shtylla elektrike, ka bërë shkelje të dispozitës së nenit 4.1 pikës b është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore 11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Koalicioni LDK-AKR, në përgjigje në ankesë të datës 08.06.2017, thekson se me të marrë urdhërin për masat e përmirësimit nga PZAP-i, lidhur me rastin Anr.119/2017, kanë urdhëruar degën e Komunës së Podujevës që të ndërmarrë veprime përmirësuese, mirëpo dega në Podujevë ka konfirmuar se për të vendosur flamujt e koalicionit zgjedhor LDK-AKR si dhe banerët e billboardët në vende dhe hapsira publike kanë marrë leje nga Komuna. Në cilsinë e provës përgjigjes në ankesë iu është bashkangjitur kërkesa për shfrytëzimin e hapësirës publike si dhe konfirmimin nga komuna e Podujevës.

Me propozim për PZAP-i, që të mos i shqiptojë gjobë subjektit politik me faktin se përmbajnë lejen e komunës.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Pretendimet ankimore se posterët e flamujt e koalicionit LDK-AKR janë të vendosur në shtylla elektrike, nuk qëndrojnë sepse fotografitë e ofruar nga parashtruesi i ankesës si dhe nga provat e ofruara në përgjigjen në ankesë nga koalicioni LDK-AKR vërteton se flamujt e koalicionit LDK-AKR janë të vendosura në vendet e dedikuara për flamuj. Andaj PZAP-i, konstaton se pretendimet e cekura në ankesë janë të pa bazuara, për të cilin pretendohet se është bërë shkelja e supozuar, andaj një pretendim i tillë u vlerësua si i pa argumentuar sepse nga provat e paraqitura vërtetohet se vendosja e flamujve të koalicionit LDK-AKR në shtylla elektrike nuk paraqet shkeljen e supozuar.

Prandaj paneli konsideron, se parashtruesi i ankesës, me dëshmitë e ofruara nuk i ka vërtetuar pretendimet e parashtruara në ankesë, në mënyrë që PZAP, të merr vendim në favor të tij.

Nga arsyet e theksuar më e duke bazuar nenin 118 par.1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr.119/2017 më datën 08.06.2017.



**Kryesnesi i Panelit  
Hasan Shala**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.